

VENDIM
Nr.42, datë 16.7.2008

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR STRUKTURËN DHE PËRDORIMIN E
NUMRIT NDËRKOMBËTAR TË LLOGARISË BANKARE (IBAN)”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja ”b”; nenit 3, pika 2 dhe pika 4, shkronja ”dh”; nenit 12 shkronja ”a”, nenet 21 e 43, shkronja ”c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 53, pika 4; nenit 124 dhe atij 129 pika 6 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për strukturën dhe përdorimin e Numrit Ndërkombëtar të Llogarisë Bankare (IBAN)”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Operacioneve Monetare me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi nr.38, datë 3.5.2000, i ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.50, datë 20.06.2001 “Për miratimin e skemës për përcaktimin e KIB për bankat e nivelit të dytë”.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë ditë) pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

ZËVENDËSKRYETAR
Fatos Ibrahimi

RREGULLORE

**PËR STRUKTURËN DHE PËRDORIMIN E NUMRIT NDËRKOMBËTAR
TË LLOGARISË BANKARE (IBAN)**

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i strukturës së numrit ndërkombëtar të llogarisë bankare - IBAN, i marrëdhënieve ndërmjet bankës dhe/ose degës së bankës së huaj dhe klientëve të tyre në lidhje me krijimin, komunikimin, njohjen dhe përdorimin e IBAN-it në Republikën e Shqipërisë, si dhe i procedurave për kontrollin e vlefshmërisë së tij prej tyre.

Neni 2

Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe në përputhje me:

- a) ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- b) ligjin “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”;
- c) rregulloren “Për sistemin dhe instrumentet e pagesave”;
- d) akte të tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë në fushën e sistemit të pagesave.

Neni 3
Fusha e zbatimit

1. Subjekte të zbatimit të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga Banka e Shqipërisë.
2. Banka e Shqipërisë zbaton dispozitat e kësaj rregulloreje në lidhje me IBAN-in në rolin e operatorit për kryerjen e pagesave për klientët e saj.

Neni 4
Përkufizime

1. Në zbatim dhe për efekt të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
 - a) Bankë - janë bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga Banka e Shqipërisë, që ushtrojnë veprimtari bankare dhe veprimtari financiare, në territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe Banka e Shqipërisë në rolin e operatorit të pagesave për klientët e saj.
 - b) BBAN – (Basic Bank Account Number) është numri bazë i llogarisë bankare, i cili përfaqëson një sekuençë alfanumerike (kod identifikues), të përdorur nga institucionet financiare në vende të ndryshme, pjesë e skemës kombëtare të përcaktimit të numrit të llogarive bankare, i cili identifikon në mënyrë unike një llogari të një klienti, në një institucion financiar.
 - c) IBAN - (International Bank Account Number) është numri ndërkombëtar i llogarisë bankare dhe përfaqëson një version të zgjeruar të BBAN, i cili përdoret në nivel ndërkombëtar, me qëllim identifikimin e llogarisë së një klienti në një bankë. Ky numër përcaktohet sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje, në përputhje me Standardin Ndërkombëtar ISO numër 13616 “Shërbimet bankare dhe të ngjashme – Numri ndërkombëtar i llogarisë bankare – IBAN”, i ndryshuar me Standardin ECBS EBS 204 “IBAN- Numri ndërkombëtar i llogarisë bankare”.
 - d) BIC – (Bank Identification Code) është kodi ndërkombëtar i identifikimit bankar, që përfaqëson një sekuençë karakteresh e cila identifikon në nivel ndërkombëtar, një bankë të licencuar për të ushtuar veprimtari bankare dhe financiare brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ky kod përcaktohet nga SWIFT sipas Standardit Ndërkombëtar ISO numër 9362.
 - e) KIB – (kodi i identifikimit bankar) është një sekuençë numerike që përdoret për të identifikuar në nivel kombëtar një bankë të licencuar për të ushtuar veprimtari bankare dhe financiare brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ky kod përcaktohet nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me bankat, sipas aneksit nr. 4 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje).
 - f) Krijimi i IBAN-it – (generation of IBAN) është procesi i krijimit të kodit IBAN për çdo llogari klienti, i cili kryhet vetëm një herë.
 - g) Njohja e IBAN-it – (capture of IBAN) është procesi i konvertimit të kodit IBAN nga forma letër në formën elektronike.
 - h) Komunikimi i IBAN-it – është procesi i njoftimit të klientit, titullar i llogarisë në lidhje me krijimin e IBAN-it për llogarinë e tij.
 - i) Transferimi i IBAN-it – është procesi i transportimit/përfshirjes së kodit IBAN në instruksionet e pagesave.
 - j) Kontrolli i vlefshmërisë së IBAN-it – është procesi i vlerësimit të saktësisë së shifrës së kontrollit të kodit IBAN.
 - k) STP – (Straight Through Processing) - është procedura e procesimit automatik të transfertave të fondeve. Ky proces inicohet duke debituar llogarinë e urdhëruesit të pagesës dhe përfundon me kreditimin e llogarisë së përfituesit të fondeve, pa ndërmjetësinë e veprimeve manuale apo të kujdesit njerëzor.
 - l) Klient – është mbajtësi i një llogarie (titullar i llogarisë) në monedhë vendase apo të huaj, pranë një banke.
 - m) Pagesë – (Urdhër pagesë) është një instruksion pa kushte, i iniciuar nga urdhëruesi/(përfituesi) për tek banka e përfituesit/(banka e urdhëruesit), i transmetuar në formë elektronike apo me letër, me qëllim transferimin dhe vendosjen e fondeve në dispozicion të përfituesit pranë bankës së përfituesit.
 - n) ECBS – (European Committee for Banking Standards) është Komiteti Evropian për

Standardet Bankare.

- o) ECB – është Banka Qendrore Evropiane.
 - p) ISO – (International Standards Organization) është Organizata Ndërkombëtare për Standardet.
 - q) SWIFT - (Society for Worldwide Interbank Financial Telecommunication) – është kompania ndërkombëtare, e cila ofron shkëmbim global të sigurt mesazhesh të formatit FIN dhe skedarësh.
 - r) Njësi e rrjetit bankar – janë degët dhe/ose agjencitë e një banke në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- 2. Në këtë rregullore fjalët në njëjës mund të interpretohen në shumës dhe anasjelltas, kurdoherë që një gjë e tillë është e nevojshme nga përmbajtja e dispozitës ose konteksti.
 - 3. Termat në gjininë mashkullore nënkuptojnë dhe gjininë femërore, dhe anasjelltas.
 - 4. Aneksat bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse e saj.

Neni 5

Funksionet e IBAN-it

Përdorimi i IBAN-it, si nga bankat iniciuese të pagesave ashtu edhe nga ato përfituese, bëhet me qëllim përmbushjen e funksioneve të mëposhtme:

- a) përpunimin automatik të identifikimit të llogarive bankare, duke ndihmuar në arritjen e procesimit STP; dhe
- b) unifikimin dhe standardizimin e procesit të kontrollit të vlefshmërisë së llogarive bankare.

KREU II

STRUKTURA E IBAN-IT

Neni 6

Elementet përbërëse të IBAN-it

1. IBAN-i, në Republikën e Shqipërisë, përbëhet prej 28 karakteresh, që përfaqësojnë elementet e mëposhtme:

- a) kodin e Republikës së Shqipërisë, “AL”, në përputhje me standardin ndërkombëtar ISO 3166 “Kodet për përcaktimin e emrave të shteteve dhe nëndarjeve të tyre”;
- b) shifrën e kontrollit të IBAN-it, 2 numra të përcaktuar në përputhje me metodën e kalkulimit MOD 97-10 sipas aneksit nr. 1, referuar standardit ndërkombëtar ISO 7064 “Teknologjia e informacionit – teknikat e sigurisë – sistemet e shifrave të kontrollit”;
- c) BBAN, i cili identifikon në mënyrë unike çdo llogari klienti në Republikën e Shqipërisë.

2. BBAN shqiptar përbëhet prej 24 karakteresh alfanumerike dhe përfshin elementet e mëposhtme:

- a) KIB – i përbërë nga 8 karaktere numerike, që përcaktojnë në mënyrë unike bankën dhe njësinë e rrjetit të saj bankar në të cilën është hapur llogaria e klientit, sipas përcaktimeve në nenin 12 të kësaj rregulloreje;
- b) llogaria e klientit – e përbërë nga 16 karaktere alfanumerike. Ky numër përcaktohet nga vetë bankat. Numri i llogarisë së klientit mund të përmbajë brenda vetes edhe shifër kontrolli, në përputhje me strukturën që çdo bankë zbaton. Në rast se numri ekzistues i llogarisë bankare përbëhet nga më pak se 16 karaktere, plotësohet me “0” përpara.

3. IBAN-i përmban vetëm karaktere alfanumerike nga A në Z (shkronja të mëdha të shtypit, latine) dhe nga 0 në 9 (numra arabikë).

Neni 7

Forma e paraqitjes së IBAN-it

1. IBAN - i paraqitet:

- a) në instruksionet elektronike të pagesave: pa hapësira boshe ose simbole ndarëse mes karaktereve alfanumerike; dhe/ose
- b) në dokumentet e pagesave në format letër: sipas grupimeve prej katër karakteresh të ndara

me nga një hapësirë boshe.

KREU III
MARRËDHËNIET NDËRMJET BANKAVE DHE KLIENTËVE TË TYRE NË LIDHJE
ME KRIJIMIN, KOMUNIKIMIN, PËRDORIMIN DHE KONTROLLIN E IBAN-IT

Neni 8
Krijimi i IBAN-it

1. Banka krijon IBAN-in në përputhje me nenin 6 dhe anekset nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.
2. Banka krijon një IBAN për çdo llogari ekzistuese, si dhe për çdo llogari të re njëkohësisht me hapjen e saj.
3. Banka mban përgjegjësi përkundrejt klientit, sipas legjislacionit civil të zbatueshëm, për saktësinë e çdo IBAN të krijuar.

Neni 9
Komunikimi i IBAN-it

1. Banka i komunikon me shkrim, çdo klienti ekzistues, mbajtës i një llogarie pranë saj, IBAN-in e llogarisë së tij.
2. Numri IBAN dhe kodi BIC i bankës, sipas rastit, i komunikohen klientit të bankës në formë të dokumentuar, si më poshtë:
 - a) nëpërmjet përcaktimit të tyre në dokumentet e hapjes së një llogarie të re, që i vihen në dispozicion klientit;
 - b) nëpërmjet komunikimit me shkrim në përgjigje të kërkesës së klientit;
 - c) nëpërmjet vendosjes së tyre në dokumentin e nxjerrjes së llogarisë; ose
 - d) nëpërmjet shfaqjes së tyre në ekranet e pajisjeve ATM dhe konfirmimet përkatëse, gjatë kohës që klienti kryen veprime në llogari dhe/ose nëpërmjet vendosjes së tyre në dokumente të tjera që lidhen me llogarinë.

Neni 10
Përdorimi i IBAN-it

1. IBAN-i, për përdorim në Republikën e Shqipërisë, me elementet përbërëse sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje, është njëkohësisht standardi kombëtar dhe ndërkombëtar i strukturës së numrit të llogarisë së klientit.
2. Numrat e llogarive bankare të klientëve, që përdoren për të kryer pagesa, në monedhën vendase ose në valutë të huaj, nëpërmjet sistemeve të pagesave apo bankave korrespondente, kanë formatin IBAN, sipas përcaktimeve të nenit 6 të kësaj rregulloreje.
3. Banka për kryerjen e pagesës, kërkon nga klienti i cili urdhëron pagesën, IBAN-in e përfituesit, në rastet kur është i aplikueshëm, si dhe kodin BIC të bankës së përfituesit. Në rastin e pagesave ndërkufitare, bankat zbatojnë dispozitën e kësaj pike dhe të pikave 4 dhe 5 të këtij neni, për atë kohë sa IBAN zbatohet në vendin e përfituesit.
4. Banka mund të refuzojë të kryejë pagesën, kur klienti nuk disponon IBAN-in e llogarisë së përfituesit të pagesës dhe/ose kodin BIC, të bankës së përfituesit.
5. Banka mund të zbatojë komisione shtesë për kryerjen e transfertës, në rastet kur klienti nuk disponon kodin IBAN të përfituesit dhe/ose kodin BIC të bankës së përfituesit. Në raste të tilla, përpara kryerjes së transfertës, banka pajis klientin me një informacion me shkrim mbi komisionet shtesë të zbatueshme.

Neni 11
Kontrolli i vlefshmërisë së IBAN-it

1. Banka, e cila përpunon dhe ekzekuton instruksionin e pagesës, kontrollon paraprakisht

vlefshmërinë e IBAN-it, në rastet kur është i aplikueshëm, të llogarive të dërguesit/ve dhe marrësit/ve, në hyrje apo në dalje, pavarësisht paraqitjes së IBAN-it në format elektronik apo me bazë letër. Në rast se verifikohet pasaktësi nga procedurat e kontrollit të vlefshmërisë së IBAN-it, banka refuzon të kryejë pagesën në fjalë.

2. Kontrolli i vlefshmërisë së IBAN-it realizohet në përputhje me “Metodën e kontrollit të vlefshmërisë së shifrës kontrolluese (check digits) të IBAN-it” sipas aneksit 3, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

3. Sistemet kombëtare për shlyerjen e pagesave kontrollojnë vlefshmërinë e IBAN-it, për instruksionet e pagesave që kryhen përmes këtyre sistemeve, dhe në rast pasaktësie refuzojnë shlyerjen e pagesave në fjalë.

KREU IV KODI I IDENTIFIKIMIT BANKAR KIB

Neni 12 **Krijimi i KIB-it**

1. KIB përfaqëson një numër identifikues për bankën dhe/ose degën e bankës që kryen transaksione pagesash dhe përbëhet nga:

a) 3 numra (n1, n2, n3) – kodi unik i bankës, i cili përcaktohet nga Banka e Shqipërisë, sipas tabelës 1, të aneksit nr. 4, bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

b) 4 numra (n4, n5, n6, n7) – kodi unik i njësisë organizative (degë/agjenci). Dy shifrat e para përcaktojnë vendndodhjen gjeografike, sipas tabelës 2, të aneksit nr. 4, bashkëlidhur kësaj rregulloreje; ndërsa dy shifrat e tjera përcaktohen nga vetë banka;

c) 1 numër (n8) – shifër kontrolli që përcaktohet në bazë të modulit 10, formula e të cilit është paraqitur në aneksin 4, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

2. Procedurat mbi përcaktimin, ndryshimin dhe mbylljen e KIB-it, janë parashikuar në dokumentin “Instruksione mbi Kodin e Identifikimit Bankar (KIB)”, sipas aneksit nr. 4, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

3. Bankat, pas marrjes së licencës bankare nga Banka e Shqipërisë, pajisen me KIB nga Banka e Shqipërisë, sipas nenit 13 të kësaj rregulloreje.

Neni 13 **Detyrimet e Bankës së Shqipërisë në lidhje me KIB**

1. Detyrimet e Bankës së Shqipërisë në lidhje me KIB janë si më poshtë:

a) pajis bankën e licencuar me një KIB unik sipas nenit 12, të kësaj rregulloreje;

b) konfirmon saktësinë e KIB-it të përcaktuar nga vetë banka, për njësitë e rrjetit të saj bankar sipas nenit 12, pika 1, shkronjat “b” dhe “c” të kësaj rregulloreje;

c) informon pjesëmarrësit në sistemet e pagesave, për KIB-it e rinj si dhe kur KIB-it pësojnë ndryshime ose mbyllen;

d) mban dhe publikon Regjistrin e Kodeve KIB.

Neni 14 **Detyrimi i bankave në lidhje me KIB**

1. Bankat njoftojnë menjëherë Bankën e Shqipërisë sipas pikës 5 të aneksit nr. 4 bashkëlidhur kësaj rregulloreje në lidhje me çdo ndryshim të mundshëm të KIB-it për të cilin mund të nevojitet kryerja e ndryshimeve përkatëse në Regjistrin e Kodeve KIB.

2. Bankat nuk kanë të drejtë të modifikojnë shifrat e KIB-it të përcaktuara sipas aneksit nr. 4, bashkëlidhur kësaj rregulloreje, dhe as të përdorin një KIB të modifikuar.

KREU V TË FUNDIT

Neni 15

Dispozita transitoare

1. Bankat krijojnë IBAN-in për çdo klient të tyre dhe ja komunikojnë atë klientit brenda datës 1 qershor 2009, në përputhje me nenin 8, pikat 1 dhe 2 dhe me nenin 9, pika 1, të kësaj rregulloreje.
2. Bankat dhe sistemet kombëtare të pagesave kontrollojnë vlefshmërinë e IBAN-it, të llogarive të përfshira në instruksionet e pagesave sipas përcaktimeve të nenit 11, pikat 1 dhe 3 të kësaj rregulloreje, duke filluar nga data 1 janar 2010.
3. Bankat pranojnë deri në datë 31 dhjetor 2009, instruksione pagesash, ku numrat e llogarive specifikohen sipas formatit IBAN ose sipas strukturave ekzistuese të llogarive.
4. Bankat informojnë Bankën e Shqipërisë çdo 6 (gjashtë) muaj që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, mbi ecurinë e masave të marra sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni.


Neni 16

Sanksionet

Banka e Shqipërisë, në rast të verifikimit të mosrespektimit dhe/ose të shkeljeve të dispozitave të kësaj rregulloreje nga ana e bankave dhe/ose degëve të bankave të huaja, ka të drejtë të vendosë një ose disa nga masat mbikëqyrëse, masat parandaluese ose masat ndëshkimore, të përcaktuara në ligjin “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Fatos Ibrahimi

ANEKS 1 STRUKTURA E IBAN-IT



N – nënkupton karakter numerik nga 0 deri në 9.

S – nënkupton karakter alfanumerik nga 0 në 9 dhe/ose nga A në Z (vetëm shkronja të mëdha).

Shembull i IBAN-it

NUMRI I LLOGARISË SË	235698741
KLIENTIT	
BBAN	212110090000000235698741
IBAN-I FORMAT ELEKTRONIK	AL47212110090000000235698741
IBAN-I FORMAT LETËR	AL47 2121 1009 0000 0002 3569 8741

ANEKS 2
METODA E PËRLLOGARITJES SË SHIFRËS KONTROLLUESE TË IBAN-IT

Hapi paraprak

Për të treguar se si përllogaritet IBAN-i, marrim një kod IBAN teorik, i cili përfshin kodin e Shqipërisë “AL”, shifrat e kontrollit “XX”, të cilat zëvendësohen me “00”, si dhe numrin e llogarisë BBAN prej 24 shifrash (pa hapësira). Si algoritëm për caktimin e shifrave të kontrollit XX përdoret procedura ISO 7064, MOD 97-10, si më poshtë:

Shembull: AL00212110090000000235698741

Hapi 1

Katër shifrat e para i zhvendosim në fund (në të djathtë) të kodit IBAN:

Bëhet 212110090000000235698741AL00

Hapi 2

Konvertohen të gjitha shkronjat në numra sipas tabelës më poshtë:

A = 10	G = 16	M = 22	S = 28	Y = 34
B = 11	H = 17	N = 23	T = 29	Z = 35
C = 12	I = 18	O = 24	U = 30	
D = 13	J = 19	P = 25	V = 31	
E = 14	K = 20	Q = 26	W = 32	
F = 15	L = 21	R = 27	X = 33	

Bëhet 212110090000000235698741102100

Hapi 3

Zbatohet MOD 97–10 (Ref ISO 7064).

Përllogaritet moduli 97 dhe numri i përfutur zbritet nga 98. Nëse diferenca jep një numër njëshifror, atëherë shtohet një zero përpara numrit.

Nga përllogaritja rezulton: $98 - 51 = 47$

IBAN është AL47212110090000000235698741

ANEKS 3
METODA E KONTOLLIT TË VLEFSHMËRISË SË SHIFRËS KONTROLLUESE
(CHECK DIGITS) TË IBAN-IT

Hapi paraprak

Në rast se IBAN-i paraqitet në format letër, së pari bëhet konvertimi në format elektronik duke hequr të gjitha hapësirat boshe midis karaktereve. Shembulli i mësipërm do të na ndihmojë të bëjmë një paraqitje të metodës së validimit të IBAN-it. Shembull:

AL47 2121 1009 0000 0002 3569 8741 bëhet AL47212110090000000235698741

Hapi 1

Zhvendosim në të djathtë katër karakteret e para:

Bëhet 212110090000000235698741AL47

Hapi 2

Shkronjat konvertohen në numra sipas tabelës pasqyruar në hapin 2, të aneksit 2:

Bëhet 212110090000000235698741102147

Hapi 3

Aplikohet algoritmi i MOD 97-10 në përputhje me ISO 7064. Në mënyrë që shifrat e kontrollit (check digits) të jenë korrekte, rezultati i marrë pas mod 97-10 duhet të jetë 1.

Mbetja pas MOD 97 e 212110090000000235698741102147 = 1

Shënim Për saktësi llogaritjeje, rekomandohet përdorimi i numrave të plotë në vend të numrave dhjetorë. Nëse kodi është një numër relativisht i gjatë për të aplikuar modulën, atëherë përlllogaritja mund të ndahet në përlllogaritje të pjesës së mbetur referuar numrit të plotë, me një gjatësi maksimale 9 ose 18 karaktere. Referuar shembullit më lart, përlllogaritja do të jetë:

(93)

- 9 shifrat e para të numrit pjestohen me 97
 $212110090 / 97 = 2186701.96$
- pjesa e plotë e numrit të marrë nga pjestimi, shumëzohet përsëri me 97
 $2186701 * 97 = 212109997$
- nga numri i parë 9-shifror zbresim numrin e dytë të marrë nga shumëzimi
 $212110090 - 212109997 = 93$
- krijohet numri në vijim 9-shifror, i paraprirë nga diferenca e përfutur nga një hap më lart
 $930000002 / 97 = 9587628.887$
- pjesa e plotë e numrit të marrë nga pjestimi, shumëzohet përsëri me 97
 $9587628 * 97 = 929999916$
- nga numri i parë 9-shifror zbresim numrin e dytë të marrë nga shumëzimi
 $930000002 - 929999916 = 86$

Kjo procedurë përsëritet deri sa të përfshihen në përlllogaritje të gjitha shifrat e numrit. MOD 97 i "201102147" = 1

ANEKS 4
INSTRUKSIONE MBI KODIN E IDENTIFIKIMIT TË BANKAVE

1. Kodi i Identifikimit të Bankave përbëhet nga 8 shifra (123,4567,8) si më poshtë:
 - a) karakteret 1, 2, 3 shërbejnë për kodifikimin e bankës/degës së bankës së huaj dhe caktohen nga Banka e Shqipërisë për secilën bankë ku:
 - numri 1 tregon llojin e bankës (sipas tabelës nr. 1);
 - numrat 2, 3 shërbejnë për numërimin sekuencial të bankave.
 - b) karakteret 4,5,6,7 shërbejnë për të identifikuar njësitë bankare (degë, agjenci) për secilën bankë, ku:
 - numrat 4, 5 shërbejnë për të identifikuar rrethin ku ndodhet njësi bankare (sipas tabelës nr.2);
 - numrat 6, 7 shërbejnë për numërim sekuencial të njësive bankare dhe përcaktohen nga vetë banka, në përputhje me politikën e saj të brendshme;
 - c) karakteri 8 shërben si shifër kontrolli për 7 numrat e parë të kodit KIB. Shifra e kontrollit llogaritet sipas modulit 101.
2. Departamenti i Sistemeve të Pagesave në Bankën e Shqipërisë, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit nga Departamenti i Mbikëqyrjes për licencimin e bankës, për të zhvilluar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë, përcakton dhe i komunikon bankës pjesën e parë të KIB (shifrat 123) në përputhje me tabelën nr. 1.
3. Bankat njoftojnë menjëherë pranë Departamentit të Sistemeve të Pagesave në Bankën e Shqipërisë në lidhje me krijimin e KIB-it për çdo njësi të re bankare të hapur, si dhe komunikojnë adresën e saktë të vendndodhjes së çdo njësie bankare të tyre.
4. Bankat njoftojnë pranë Departamentit të Sistemeve të Pagesave në Bankën e Shqipërisë në rastet kur:
 - a) ka ndryshime për shkak të politikave të bankës (bashkime, mbyllje, falimentime etj.);
 - b) ka ndryshime të vendndodhjes së degëve/agjencive të saj për sa i përket rajonit;
 - c) mbyllet një/ose disa prej njësive të tyre bankare (degë/agjenci).
5. Bankat komunikojnë KIB në çdo dokument të nxjerrë prej tyre, me përjashtim të dokumenteve ku jepen IBAN dhe BIC.
6. Banka e Shqipërisë publikon regjistrin e përditësuar të kodeve KIB, pas çdo ndryshimi të njoftuar nga bankat, referuar pikave 3 dhe 4.
7. Banka e Shqipërisë informon kompaninë SWIFT, për ndryshimet në tabelën e kodeve KIB.

¹ Algoritmi per moduln 10: $S_8 = 10 - \text{ë}(S_1*9+S_2*7+S_3*3+S_4*1+S_5*9+S_6*7+S_7*3) \text{ MOD}10]$
- ku S_n është vlera e shifres se n-te te KIB.

TABELË NR. 1.
STRUKTURA E KIB.

POZICIONI	QËLLIMI	VLERAT E MUNDSHME
SHIFRA 1	KLASIFIKIMI I BANKAVE	1. BANKA QENDRORE 2. BANKAT 3. PA CAKTUAR 4. PA CAKTUAR ... 9. DEGËT E BANKAVE TË HUAJA
SHIFRAT 2 DHE 3	IDENTIFIKIMI SEKUENCIAL I BANKËS	NUMËR SEKUENCIAL UNIK PËR ÇDO BANKË
SHIFRAT 4,5,6 DHE 7	IDENTIFIKIMI I DEGËS/AGJENCISË	4 DHE 5 IDENTIFIKUES I RRETHIT, SIPAS TABELËS NR. 2; 6 DHE 7 NUMËR SEKUENCIAL UNIK PËR ÇDO DEGË/AGJENCI TË BANKËS, VENDOSSET NGA VETË BANKA.

TABELË NR. 2.
NDARJA ADMINISTRATIVE NË RRETHE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

RAJONI ² / DEGA E B.SH (1)	NUMRI I RAJONIT (2)	RRETHET (KRYEQENDRAT) (3)	NUMRI I RRETHIT (4)	KODI I RRETHIT (2+4)
TIRANË	1	TIRANË	1	11
	1	DURRËS	2	12
	1	KRUJË	3	13
	1	KURBIN (LAÇ)	4	14
	1	MIRDITË (RRËSHEN)	5	15
	1	KAVAJË	6	16
	1	MAT (BURREL)	7	17
LUSHNJË	2	FIER	1	21
	2	LUSHNJË	2	22
	2	BERAT	3	23
	2	KUÇOVË	4	24
	2	SKRAPAR (ÇOROVODË)	5	25
	2	VLORË	6	26
	2	MALLAKASTËR (BALLSH)	7	27
ELBASAN	3	ELBASAN	1	31
	3	GRAMSH	2	32
	3	PEQIN	3	33
	3	LIBRAZHD	4	34
KORÇË	4	KORÇË	1	41
	4	POGRADEC	2	42
	4	DEVOLL (BILISHT)	3	43
	4	ERSEKË	4	44
SHKODËR	5	SHKODËR	1	51
	5	MALËSI E MADHE (KOPLIK)	2	52

² Numërimi i rretheve bëhet mbi baza rajonale, duke konsideruar si qendra të rajoneve qytetet ku ndodhen degët e Bankës së Shqipërisë.

	5	PUKË	3	53
	5	LEZHË	4	54
	5	KUKËS	5	55
	5	HAS	6	56
	5	TROPOJË (BAJRAM CURRI)	7	57
	5	DIBËR (PESHKOPI)	8	58
	5	BULQIZË	9	59
GJIROKASTËR	6	GJIROKASTËR	1	61
	6	PËRMET	2	62
	6	SARANDË	3	63
	6	TEPELENË	4	64
	6	DELVINË	5	65